



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, Ref. Nr. 72/20

Datë: 04 Dhjetor 2020

Duke u bazuar në nenet 28, 29, 33, 35, 36, 37, 38, si dhe neni 54, paragrafi (2) me nën paragrafët 2.1 dhe 2.2 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjithashtu duke u bazuar në Vendimin Nr. Ref - 67/20 për fillimin e shqyrtimit paraprak për monitorimin e tregut në sektorin e energjisë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të informatave që posedon dhe dyshimeve të bazuara për Marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar sipas nenit 4 si dhe abuzim me pozitën dominuese sipas nenit 11 të Ligjit, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën **04 Dhjetor 2020** merr këtë:

**KONKLuzion**

- I. Për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS Sh.a. me NUI: 810799364 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5 dhe KESCO Sh.a. me NUI: 811288887 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5, për shkak të dyshimeve të bazuara për arritjen e Marrëveshjes së ndaluar apo praktikë të bashkërenduar si dhe Abuzim me Pozitën Dominuese, e ndaluar dhe e ndëshkuar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 dhe 11.
- II. Autoriteti, kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura si në dispozitivin (I) të këtij konkluzioni, që në afat prej **30 ditësh** t'i dorëzojnë në zyrat e Autoritetit këto dokumente dhe bashkë me dokumentacionin e ofruar pala është e detyruar t'i dorëzojë komentet të cilat kanë të bëjnë me lëndën në procedurë.

**KEDS sh.a.** detyrohet t'i dorëzojë këto dokumente në afatin e paraparë më lartë:

- a. Të gjitha bartjet e pronave private ku gjinden trafo-stacionet elektro-energjetike (mbi 250kw) e cilat figurojnë në pronësi të KEDS-it në sistemin kadastral të komunave në Republikën e Kosovës nga data 01.06.2016 deri më 04.12.2020 - Certifikata e pronësisë (fletën poseduese).
- b. Të gjitha marrëveshjet e noterizuara për bartje të pronave private ku gjinden trafo-stacionet elektro-energjetike të KEDS-it (mbi 250kw) nga data 01.06.2016 deri më 04.12.2020.
- c. Të gjitha pëlqimet elektro-energjetike të lëshuara nga KEDS-se për trafo-stacionet (mbi 250kw) e investuara nga data 01.06.2016 deri më 04.12.2020.
- d. Të gjitha pranimet teknike të trafo-stacionet elektro-energjetike (mbi 250kw) nga data 01.06.2016 deri më 04.12.2020.
- e. Të gjitha vendimet për mos aprovim të pranimit teknik të trafo-stacioneve (mbi 250kw) bazën ligjore të mos aprovimit dhe arsyetimin nga data 01.06.2016 deri më 04.12.2020.

- f. Për secilin trafo-stacion (mbi 250kw) që gjindet në Republikën e Kosovës, në formatin *excel* të listohet modeli i pajisjeve marka e prodhuesit të pajisjeve, prejardhja e pajisjeve në trafo-stacion, furnizuesit apo shitësit me pakicë në Republikën e Kosovës.
- g. Të dorëzohet arsyetimi ligjor sipas ligjeve të Republikës së Kosovës për të ashtuquajturin “TIP TEST”.
- h. Të dorëzohet lista e të gjitha trafo-stacioneve (mbi 250kw) për të cilat është kërkuar “TIP TEST” për pajisjet e vendosura brenda trafos.
- i. Të dorëzohen të hyrat e taksës 15E/KW të inkasuar nga KEDS sh.a. data 01.06.2016 deri më 04.12.2020.
- j. Të dorëzohet arsyetimi ligjor i taksës 15E/KW.
- k. Të dorëzohen të gjitha transaksionet financiare ndërmjet KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. dhe për secilin transaksion të ipet arsyetim i qartë (*kjo të dëshmohet nëpërmjet gjendjes së llogarisë bankare*).
- l. Të ipet një arsyetim i qartë i lidhshmërisë së ndërmarrjeve KEDS sh.a me KESCO sh.a. (*struktura organizative e ndërmarrjes për vitin 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020, lista e menaxhmentit e KEDS-it sh.a. dhe KESCO sh.a. – (emrat e tyre)*).
- m. Të dorëzohen pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016, 2017, 2018, 2019.
- n. Të konfirmohet se KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. shfrytëzojnë të njejtin objekt afarist, shkëmbejnë menaxhmentin apo edhe ekspertët përkatës dhe e kanë vetëm një zyre të përbashkët të kontabilitetit.
- o. Të dorëzohen të gjitha marrëveshjet afariste ndërmjet KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. (psh marrëveshjen të cilën KESCO sh.a. e shfrytëzon rrjetin e KEDS sh.a. për furnizim me energji tek konsumatori fundor dhe marrëveshjet tjera afariste).
- p. Të dorëzohen të gjitha marrëveshjet afariste ndërmjet KEDS sh.a. dhe ndërmarrjet tjera të licensuara për furnizim me energji elektrike (psh. Marrëveshje KEDS sh.a. me Future Energy Trading and Exchange Dynamics, HEP-KS, GSA Energy).
- q. Të dorëzohet arsyetimi ligjor për ndërrimin e njehsorëve të konsumatorëve si dhe informata se çfarë ka ndodhur me njehsorët e ndërruar.

**KESCO sh.a.** detyrohet t'i dorëzojë këto dokumente në afatin e paraparë më lartë:

- r. Të dorëzohen të gjitha transaksionet financiare ndërmjet KESCO sh.a. dhe KEDS sh.a. dhe për secilin transaksion të ipet arsyetim i qartë (*kjo të dëshmohet nëpërmjet gjendjes së llogarisë bankare*).
- s. Të ipet një arsyetim i qartë i lidhshmërisë së ndërmarrjeve KESCO sh.a. me KEDS sh.a. struktura organizative e ndërmarrjes për vitin 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020, lista e menaxhmentit e KESCO sh.a. - emrat e tyre.
- t. Të dorëzohet Marrëveshja për Furnizim me Shumicë ndërmjet KESCO sh.a. dhe KEK sh.a.
- u. Të dorëzohen pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016, 2017, 2018, 2019.

**III.** Në rast se palët në procedurë nuk i dorëzojnë komentet dhe dokumentet e kërkuara si në dispozitivin II të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatoj shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 2% të qarkullimit vjetor të vitit paraprak, dhe pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur mjetet tjera ligjore të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**IV.** Periudha e hetimit për ndërmarrjet e përcaktuar në dispozitivin (I) të këtij konkluzioni është nga: **01.06.2016** deri më **04.12.2020**.

**V.** Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.



## ARSYETIM

### PROCEDURA E NDJEKUR

Bazuar në raportin e shqyrtimit paraprak në tregun e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Kosovës, dhe në bashkëpunim me autoritetet publike, gjithashtu me akterët e ndryshëm të shoqërisë, ekspert të fushës përkatëse, ndërmarrës dhe qytetarë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës si organ i pavarur i Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili është në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ka arritur që t'i forcojë dyshimet dhe pretendimet e tij, se ndërmarrjet KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. të cilat operojnë në tregun e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar dhe/ose kanë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përkatësisht nenin 4 dhe 11.

### PALËT NË PROCEDURË:

1. Palë në këtë procedurë të zhvilluar nga Autoriteti konsiderohen:
  - a. KEDS sh.a. me NUI: 810799364 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5
  - b. KESCO sh.a. me NUI: 811288887 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5

### PËRSHKRIMI I RASTIT:

2. Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Kosovës, Autoriteti ka konsultuar dokumente të shumta rreth funksionimit dhe operimit të këtij tregu. Ka analizuar me kujdes bazën ligjore të funksionimit të sektorit të energjisë elektrike dhe në dritën e kësaj ka grumbulluar dëshmi dhe dokumente të vlefshme, ka zhvilluar intervista dhe biseda me akterë të ndryshëm të shoqërisë, me qëllimin e vetëm, që t'i forcojë dyshimet e veta mbi shkeljet potenciale që palet në procedurë i kanë bërë në këtë treg.
3. Dyshimet e bazuara të Autoritetit janë se ndërmarrja KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. kanë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në treg dhe kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar duke rënë ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përkatësisht nenin 4 dhe 11.
4. Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike ka vërejtur se pala në procedurë KEDS sh.a. ka abuzuar me pozitën dominuese:
  - a) Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)
  - b) Duke kërkuar nga BRE-të por edhe investitorët e tjerë, që në rastet kur ata bëjnë investime në trafo-stacione, ato investime dhe prona ku gjendet trafo-stacioni të barten në pronësi të ndërmarrjes KEDS sh.a.
  - c) Duke vendosur kufizime në pajisje apo produkte që nevojiten për t'u kyçur në sistemin e shpërndarjes, duke kërkuar nga investitori që të gjitha pajisjet që nevojiten që instalohen të jenë të një marke të pranueshme për KEDS sh.a. si dhe të kenë teste të tipit të duhur sipas procedurave të brendshme të KEDS sh.a.
5. Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike gjithashtu ka vërejtur se palët në procedurë KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. kanë arritur Marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar:



- a. Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj operatorëve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe investitorëve tjerë, në atë mënyrë që:
  - i. Ka shfrytëzuar të njëjtin objekt
  - ii. Ka shfrytëzuar ekspertët e njëjtë
  - iii. Ka mbajtur kontabilitetin e përbashkët nga e njëjta zyre
  - iv. Ka bërë shkëmbimin e informacioneve.
  
6. Se çfarë u tha në pikën 4, ndërmarrja KEDS sh.a në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthort kanë vendosur çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të pa drejta tregtare, kanë zbatuar kushte të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet tjera duke i sjellë ato në një pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën dhe kanë vendosur çmime ose e kushte tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjes jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre.
  
7. Se çfarë u tha në pikën 5 ndërmarrjet KEDS sh.a dhe KESCO sh.a kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar në atë mënyrë që: kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese; kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
  
8. Andaj, nga ajo që u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 36, të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

**K ë s h i l l a j u r i d i k e :** Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa e as padia për iniciimin e konfliktit administrativ.

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS  
KOMISIONI**

  
Ahmet KRASNIQI  
Zv. Kryetar

  
Fatime HAZIRI  
Anëtare

  
Valon PRESTRESHI  
Kryetar

  
Muhamed KRASNIQI  
Anëtarë

  
Shaqir MORINA  
Anëtarë



ES-111RRC

Me këtë **KONKLuzion** të njoftohen:

- Arhiva
- Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS)
- Kosovo Electricity Supply Company J.S.C SH.A. (KESCO)